



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE

Rruga Agim Ramadani, Ndërtesa e Fakulteteve Teknike, 10 000 Prishtinë, Republika e Kosovë

Tel: +383 38 552 162 ext. 101 \* E-mail: [fim@uni-pr.edu](mailto:fim@uni-pr.edu) \* [www.fim.uni-pr.edu](http://www.fim.uni-pr.edu)

Formulari -F2

UNIVERSITETI I PRISHTINES "HASAN PRISHTINA"  
FAKULTETI I INXHINIERISË MEKANIKE  
PRISHTINE

Pranuar me: 22.05.2025			
Ni. org.	Numër	Shtojca	Vlera
08	782	-	-

RAPORT VLERËSIMI TË DORËSHKRIMIT TË PUNIMIT TË  
DIPLOMËS MASTER

FAKULTETI	Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike
Departamenti/Programi	<b>Prodhimtari dhe Inxhinieri Industriale me Menaxhment</b>
Titulli i punimit	<b>Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë</b>  <i>Engl. Quality analysis and standards for the production of electrofilters in the energy industry</i>
Kandidati	Bsc. <b>Fatjon Gjukaj</b>
Mentori	Prof. dr. Mirlind Bruçi
Aprovimi i projekt propozimit në Këshillin e Fakultetit	Datë: 02.05.2024 Vendimi Nr.: 632/3-12

Vlerësimi i dorëshkrimit.

Punimi (dorëshkrimi i punimit) me titull: **“Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë”**, e kandidatit Fatjon Gjukaj, *bachelor*, është punuar në gjithsej 76 faqe tekst të formatit A4, në vazhdim të cilës është dhënë deklarata studentit për punë autentike dhe shtojca e bashkangjitur. Në kuadër të tekstit janë përfshirë figura dhe tabela. Punimi është strukturuar në 5 kapituj se bashku me përfundimin, si dhe literaturën e shfrytëzuar me 12 njësi bibliografike.

Metodologjia e përdorur për strukturimin e punimit është e konceptuar mbi baza shkencore dhe shumë të përshtatshme edhe nga ana praktike dhe didaktike. Shtjellimi i punimit për secilin kapitull është bërë me kujdes, si dhe në mënyrë profesionale dhe shkencore.

Ky punim shqyrton menaxhimin e cilësisë në proceset industriale, me fokus në standardin ISO 9001, rëndësinë e sistemeve të filtrimit në prodhimin e energjisë dhe përdorimin e teknologjisë LP Cleaning për rritjen e efikasitetit të filtrave. Cilësia është një faktor kyç në optimizimin e operacioneve industriale, duke ndikuar drejtpërdrejt në koston, sigurinë dhe ndikimin mjedisor. Një pjesë e rëndësishme e studimit është ISO 9001, i cili siguron një kornizë të standardizuar për kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në prodhim dhe mirëmbajtje. Implementimi i tij ndihmon në rritjen e performance .

Po ashtu në kuadër të temës është analizuar ndikimin e ISO 9001 në përmirësimin e cilësisë së filtrave industriale dhe në optimizimin e sistemeve të LP Cleaning. Janë shqyrtuar metodat e menaxhimit të cilësisë, efektet e standardizimit në efikasitetin e filtrave dhe sfidat e zbatimit të ISO 9001 në këtë sektor. Gjithashtu, janë analizuar edhe përfitimet që sjell ky standard në rritjen e performancës,

## Formulari – F2

zvogëlimin e kostove të mirëmbajtjes dhe përmirësimin e qëndrueshmërisë së impianteve energjetike.

Në përfundim, studimi demonstroi se integrimi i standardeve si ISO 9001, përdorimi i filtrave të avancuar dhe teknologjive si LP Cleaning nuk janë thjesht mjete për përputhje me rregulloret, por edhe mekanizma për të arritur konkurrencë globale, qëndrueshmëri mjedisore dhe efikasitet ekonomik.

Mbështetur në problematikën e shqyrtuar në këtë punim, komisioni është i mendimit se metodologjia e zbatuar për rastin e prodhimit të elektrofiltrave në industrinë e energjisë duke u bazuar në standardeve ISO 9001, ku është prezantuar në mënyrë profesionale.

Tema në fjalë paraqet një kontribut profesional dhe shkencor të kandidatit, andaj punimi i masterit me titull **“Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë”**, i kandidatit BSc. Fatjon Gjukaj, i dorëzuar për vlerësim, i përmbush kushtet dhe kriteret e një punimi të masterit.

### Konkluzioni i Komisionit

Në bazë të vlerësimit të punimit të masterit me titull: **“Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë”**, e kandidatit BSc. Fatjon Gjukaj.

Komisioni sjellë këtë

### K o n k l u z i o n

Punimi i masterit me titull **“Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë”**, i kandidatit BSc. Fatjon Gjukaj, i përmbush parakushtet metodologjike, profesionale-shkencore dhe etike si temë për punim të masterit. Punimit i është bashkëngjitur edhe Deklarata e studentit për punë autentike.

Prandaj, në mbështetje të Statutit të Universitetit të Prishtinës dhe në mbështetje të Rregullores për studime master, Komisioni për vlerësim, unanimisht dhe me kënaqësi i:

### P r o p o z o n

Këshillit të Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike në Prishtinë, të miratojë Raportin për vlerësimin e punimit për master me titull **“Analiza e cilësisë dhe standardeve për prodhimin e elektrofiltrave në industrinë e energjisë”**, i kandidatit BSc. Fatjon Gjukaj, dhe të bëjë procedimin e mëtejshëm, përkatësisht të formojë Komisionin për mbrojtje dhe të caktojë datën për mbrojtje publike të punimit.

Prishtinë: 21/05/2025

Komisioni:


1. Prof. dr. Nexhat Qehaja

  
\_\_\_\_\_  
- kryetar

2. Prof. dr. Mirlind Bruçi

  
\_\_\_\_\_  
-mentor, anëtar

3. Prof. asoc. Dr. Afrim Gjellaj

  
\_\_\_\_\_  
- anëtar

P.S. Numri i faqeve shtohet sipas nevojës.

## **ABSTRAKT**

Ky studim shqyrton menaxhimin e cilësisë në proceset industriale, me fokus në standardin ISO 9001, rëndësinë e sistemeve të filtrimit në prodhimin e energjisë dhe përdorimin e teknologjisë LP Cleaning për rritjen e efikasitetit të filtrave. Cilësia është një faktor kyç në optimizimin e operacioneve industriale, duke ndikuar drejtpërdrejt në koston, sigurinë dhe ndikimin mjedisor.

Një pjesë e rëndësishme e studimit është ISO 9001, i cili siguron një kornizë të standardizuar për kontrollin dhe përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë në prodhim dhe mirëmbajtje. Implementimi i tij ndihmon në rritjen e performancës operacionale dhe garantimin e një funksionimi të qëndrueshëm të sistemeve industriale.

Në sektorin e energjisë, filtrimi i ajrit dhe gazrave është thelbësor për të reduktuar emisionet ndotëse dhe për të mbrojtur mjedisin. Kjo teknologji ndihmon në largimin e grimcave të dëmshme, duke siguruar një funksionim më efikas të impianteve energjetike dhe duke kontribuar në respektimin e standardeve mjedisore dhe rregullatore.

Nga ana tjetër, sistemi LP Cleaning sjell një qasje inovative në pastrimin e filtrave, duke përdorur impulse ajri me presion të ulët për të hequr depozitimet e pluhurit në mënyrë efektive. Kjo metodë ndihmon në zgjatjen e jetëgjatësisë së filtrave, uljen e konsumit të energjisë dhe reduktimin e shpenzimeve të mirëmbajtjes, duke siguruar një proces më të qëndrueshëm dhe efikas për industrinë.

Në përfundim, studimi ofron një analizë të detajuar mbi rolin e cilësisë në industrinë e prodhimit, ndikimin e ISO 9001, filtrimin industrial dhe përfitimet e sistemit LP Cleaning. Gjetjet e tij mund të shërbejnë si bazë për përmirësime të mëtejshme në proceset industriale dhe për një menaxhim më efikas të filtrimit në sektorin e energjisë.